

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Punonjës Mbështetës në Terren, Drejtoria e Kontrollit të Terrenit, Tirana Veri, Zona I (Kategoria, Klasa IX).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për për zgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë ose dëftesë e arsimit të mesëm, (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS*);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Punonjësi Mbështetës në Terren ka për detyrë si më poshtë:

Punonjësi Mbështetës në Terren varet direkt nga Përgjegjësi i Sektorit.

- Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Përgjegjësi i Sektorit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.
- Trajton ankesat e marra nga insitucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizikë e juridik.
- Merr masat për zgjidhjen e tyre.
- Inspekton në mënyrë të vazhdueshme territorin e Njësisë Administrative në të cilin është caktuar nga Drejtori i Kontrollit të Terrenit, Tirana Veri dhe Kryeinspektori.

Dokumentat që aplikanti për Punonjës Mbështetës në Terren, Drejtoria e Kontrollit të Terrenit, Tirana Veri, Zona I, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm) dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Vërtetim i aftë për punë;
7. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 26.09.2024 **ora** 16.30.